



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

35952
Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 01/11/2016

URDHËR


Nr. 25, Datë 01/11/2016

“PËR
DELEGIMIN E FIRMËS”

Në mbështetje të nenit 17, të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, nenit 26 të Ligjit nr. 90, datë 27.9.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; nenet 28 dhe 29, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e të drejtës së firmës, Z. Xhavit Çurri, me detyrë Zv\Drejtor i Përgjithshëm, për firmosjen e shkresave zyrtare, të cilat kanë lidhje me:
 - Përcjelljen për kompetencë Drejtorive Rajonale, të kërkesave të tatimpaguesve për korigjimin e gabimit në përdorimin e pajisjeve fiskale.
 - Kthim - Përgjigjet për përmbaruesit gjyqësorë private, në kuadër të kërkesave të tyre për informim.
2. Ngarkohen për zbatim të këtij Urdhëri: Z. Xhavit Çurri; Drejtoria e Shërbimit ndaj Tatimpaguesve; Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore.
3. Drejtoria e Shërbimit ndaj Tatimpaguesve, të marrë masat për publikimin e këtij Urdhëri në faqen zyrtare të internetit www.tatime.gov.al.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe është i vlefshëm deri në daljen e një urdhëri të dytë të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.



DREJTORI I PËRGJITHSHËM

VASILIKA VJERO